



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 55 Datë 11.09. 2007

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75%+1 të aksioneve të Sigma sha nga shoqëria TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Z. Lush Përpali | Zv/kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço Broka | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimi për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 75%+1 të aksioneve nga Sigma sh.a te TBIH Financial Servis Group N.V (TBIH).

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

1. TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH), blerësi i pjesës prej 75 % +1 të kapitalit aksionar të Sigma sh.a, është shoqëri e themeluar sipas ligjeve hollandeze me seli në Prins Hendriklaan 52, 1075 BE Amsterdam,

Hollandë. TBIH është një grup shërbimesh financiare me aktivitet në fushën e sigurimeve dhe pensioneve.

Për vitin 2006, xhiro në tregun ndërkombëtar e TBIH është 190 609 000 Euro ose 23 444 907 000 lekë.

2. SIGMA sh.a, e themeluar në dhjetor 1998 është pjesë e sistemit financiar shqiptar, e licensuar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. SIGMA është kryesisht aktive në fushën e sigurimit të jo-jetës. pjesa e tregut të shoqërisë SIGMA sh.a në tregun shqiptar të sigurimeve është 18.4 %. Sigma sh.a zotëron 100 për qind të aksioneve të Sigmës në Maqedoni dhe ka një degë në Kosovë. Me një numër total prej 25 degë dhe agjentë në të tre tregjet, SIGMA sh.a ka një rrjet ndërkombëtar shpërndarje duke realizuar një fitim të përgjithshëm prej 15 milionë euro në të tre vendet.

Sigma sh.a zotëron 25 për qind të aksioneve të Garantsig, një shoqëri administruese e fondeve të pensioneve private vullnetare. Objekti i aktivitetit të Garantsig është mbledhja e kontributeve dhe shpërndarja e përfitimeve midis personave që marrin pjesë në Fondin privat të Pensioneve në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

3. Struktura e aksioneve të SIGMA sha përbëhet nga 14 aksionerë, ku më i vogli zotëron 2 të aksioneve dhe më i madhi 19 % të aksioneve.
4. Për vitin 2006, Xhiro totale në tregun kombëtar e Sigma sha është 779 milionë lekë.
5. Transaksioni i njoftuar konsiston në kontrollin e paketës prej 75. %+1 aksione të Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) dhe nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private.
6. Ky transaksion, përbën përftimin e kontrollit të një pjesë të konsiderueshme të kapitalit aksioner dhe të së drejtës së votës dhe është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

Vlerësimi i Konkurrencës

7. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

7. a Tregu i produktit:

Referuar Ligjit të gjitha shërbimet e ofruara apo përftuara nga konsumatorët në tregun përkatës, nga palët në këtë transaksion janë konsideruar produkte(kryeja e sigurimit të dëmeve në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti), sipas përcaktimit të licensave të lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare(Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve):

- a. Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
 - b. Sigurimet motorrike
 - c. Sigurimi i avionëve, anijeve, marinës dhe transportit
 - d. Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë
 - e. Sigurimi i Përgjegjësive
 - f. Sigurimi i Kreditit dhe Garancive
- Në tregun e produktit të sigurimit të dëmeve Sigma zotëron 18.4 për qind të tregut të ndarë sipas primeve të nënshkruara. Në total tregu i sigurimeve të përgjithshme(jo jetës) ishte 34 milionë e 143 mijë euro dhe Sigma zotëronte 6 milionë e 283 mijë euro prime sigurimi të nënshkruara.
- Në tregun e pensioneve vullnetare veprojnë tre shoqëri dhe sigma sh.a është e pranishme në mënyrë të tërthortë duke zotëruar 25 % të kapitalit të Garantsig IPP sh.a, pra aktualisht Sigma nuk ka paketën kontrolluese të por sipas marrëveshjes së shitjes së aksioneve ajo ka si synim të rrisë pjesëmarrjen e saj në Garantsig deri në 75 % të aksioneve.

7.b. Tregu gjeografik: Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Por, duke qënë se pasojat e veprimtarisë së palëve do të ndihen direkt në tregun e brendshëm, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

Theksojmë se palët veprojnë në tregje gjeografike të veçanta dhe nuk kanë klientë të përbashkët.

8. Konkurrentët në tregun kombëtar

- A. Në tregun shqiptar të sigurimeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 11 shoqëri të sigurimeve nga të cilat 3 në shërbimin e sigurimit të jetës dhe 8 shoqëri në sigurimin e shërbimeve të jo-jetës. Tregu shqiptar i sigurimeve realizoi një volum primesh të nënshkruara bruto prej 36.4 milionë euro dhe tregu është i orientuar kryesisht në sigurimet e jo jetës të cilat përbëjnë 93.2 % të tregut të përgjithshëm. Totali i primeve të sigurimeve të përgjithshme(pa përfshirë sigurimet e jetës) është 34 milionë e 143 mijë euro. Konkurrentët kryesorë të Sigma sh.a janë Sigal që zotëron 27.34 për qind të tregut, Insig me 18.64 për qind të tregut ndërkohë që më pak pjesë tregu kanë shoqëritë e tjera të sigurimeve.
- B. Tregu i sigurimeve të përgjithshme (kryesisht të detyrueshme) është i hapur për hyrje të reja, me një numër të kënaqshëm të shoqërive të

sigurimeve dhe mbikëqyret nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

- C. Në tregun e pensioneve vullnetare aktiviteti është i kufizuar me një fond të krijuar prej 13.25 milionë lekë dhe numër kontribuesish rreth 2600 persona. Në këtë treg ushtrojnë aktivitet 3 shoqëri sigurimesh dhe duhet theksuar se tregu është në fazat e para të tij me një numër modest kontribuesish dhe fond të krijuar. Garantsig ka filluar aktivitetin më 1 janar 2006 dhe brenda atij viti kishte rreth 892 kontribues(ose 34 % të numrit total të të gjithë tregut) që kanë derdhur 2.62 milionë lekë kontribute(ose 19.7 për qind të të gjithë tregut).

Si konkluzion, meqënëse transaksioni i njoftuar i kontrollit të paketës prej 75. %+1 aksione të Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve dhe tregut të pensioneve private.

Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese duke qënë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, pasi nuk rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim. Pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

1. Të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së pjesës 75% +1 të aksioneve të shoqërisë Sigma sh.a nga TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R